

BIBLIOTEKA


BH-1

P24

NDOC PAPLEKA

*Gjethnaja
në trup*

POEZI



8SH-1
P24



Ndoc
Papeleka

SEVIM ALBANA

Kopertina
SAFO MARKO

Recenzues
Isak Beshimi
Ymer Çiraku

Gjethnaja në trup

POEZI

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

GJETHNAJA NË TRUP

Plepa,
Ma jepni atë erë
Që s'e lë të qetë asnjë çast
Gjethnajën tuaj.

O plepa,
Ma jepni gjethnajën tuaj
Ta kem brenda në trup!

BISEDE IMAGJINARE ME NJË PUNËTOR

Të shoh tek kalon pranë vitrinës me libra poetikë,
Pa u ndalur, pa e kthyer kokën.
Tek ajo vitrinë është edhe libri im
Që ndoshta kurrë s' do ta marrësh në dorë.
Kjo gjë më brengos, por ti nuk ke faj.
E di: fajtor është tjetërkush.
Fajtor është ai që përdori pa kursim fjalët
Zjarr, flakë, flakadan, vullkan e prush
Në vargje që s' të bëjnë as të qash, as të qeshësh.
Që s' të dhanë asnjë pikë ngrohtësi:
Këto vargje të ftohta të ftohën me poetët
Dhe poezinë e larguan nga ti. . .
Fundja, për librin tim mendo ç'të duash,
Në daç blije, në daç lëre ta zverdhë dielli,
Veç mos më krahaso kurrsesi me një nëpunës
Që e merr rrogën duke nxjerrë disa herë në ditë
Stilografën nga xhepi.
Pa shihmi duart njëherë:
Vërtet janë të bardha e të buta,
Por kam një kallo si xhungë në gishtin e mesit,
Që s' bie më poshtë nga kallot e tua.
Më beso, nuk është e lehtë të rrish në karrige
Pa lëvizur 5-6 orë nga vendi,
Kur në kryqe të shpon një thikë
Dhe sytë të mjegullohen, të djegin. . .

Këto fjalë mund të të duken si një apologji,
Mund t'i marrësh edhe si vetëlavdërim:
Sidoqoftë, mos mendo se mund të bëjë poezia pa ty
Dhe ti pa poezinë.

DIELLI HYN E DEL NËPËR SYRIN TIM

Dielli hyn e del nëpër syrin tim

Si një kyç i ndritshëm,

Hap dyert e ditëve,

mbyll dyert e netëve.

Më sjell trishtimin e butë të një muzgu me shi,

Gjallërinë e pafre të një mëngjesi me diell,

Që më duket si mëngjesi i parë i botës.

I çel pemët

për të më kënaçur me ngjyrat e tyre.

I rrezon lulet për të rritur kokrrat.

Ma bie lotin në cep të qerrikut.

Ma lë brengën në shteg të ballit.

Befas m'i mbush pëllëmbët me flutura

Dhe buzët me luleshqerra livadhi.

Ma vë përballë njeriun e lig

që ta shoh si rrokulliset,

Ma nxjerr përpara njeriun fisnik

që t'i shkel nëpër gjurmë.

Lëshon erën të m'i rrëmbejë fjalët pa peshë,

Më pëshpërit në ëndërr një mendim të bukur

Që e rigjej i ngazëllyer të nesërmen.

Merr përkrahu një vajzë me sy të kulluar,

Ecën rrugëve ku eci unë

për të ma habitur zemrën...

Dielli hyn e del nëpër syrin tim

Si një kyç i ndritshëm,

Më zbulon përditë të papriturat e jetës.

LISI NË KODËR

Atë lis në kodër
E ke pasur mësuesin e parë në jetë
Dhe mësimi i parë që të ka dhënë,
Ka qenë: Qëndresa.

Sa herë që sëpatat e plagosën,
I mbylli plagët me lëvore të re
Dhe mësimi i dytë që të ka dhënë,
Ka qenë: Qëndresa.

E zhuriti rrufeja mizore,
Nga trungu shpërthyen bisqe të gjelbra
Dhe mësimi i tretë që të ka dhënë,
Ka qenë: Qëndresa.

Degët e tij u mbushën prapë me zogj,
Ata kënduan vetëm për jetën
Dhe mësimi i katërt që të ka dhënë,
Ka qenë: Qëndresa...

Në të gjitha librat që ke hapur,
Ai lis është shfaqur para teje.

Gjithçka që ke mësuar, ka pasur në thelb
Urtësinë e tij: Qëndresën:

Ai lis në kodër
Të ka mbirë në zemër.
Ai lis në kodër
Shushurin brenda teje.

VEGIM FËMIJËRIE

Shkova pas karvanit të reve.

Ishin vasha të veshura me të bardha,
Me kezë dielli mbi flokë.

Aq i kaltër ishte qielli,
Sa të vinte keq ta shikoje,
Se mos ia ndotje kaltërinë.

Aq i kulluar ishte ajri,
Sa kishe frikë mos e përdhosje
Me hukamën tënde.

Aq e pafund ishte jeta,
Sa ngjante me një ëndërr...

Shkova pas karvanit të reve.

Ata u ngjajnë shtëpive me grila të mbyllura,
Ku troket në derë vetëm postieri.
Librat me gjurmë gishtash, me shënime
Janë si ato shtëpitë pak rrëmuje,
Kur sapo kanë ikur miqtë. . .

MUZG

Muzg.

Drurët mbështeten te shoku-shoku

Si silueta të dashuruarish,

Shtrengohen si njerëzit që kanë të ftohtë.

As drurët s'e durojnë dot vetminë.

NJOH NJË POET...

Njoh një poet të paqetë si lumenjtë.
Njërin vesh e mban te kraharori i ditës së sotme,
Me veshin tjetër
përgjon hapat e ditës që vjen.
Karriera që gjithë jetën ka lakmuar më shumë,
Janë të përpjetat që të çojnë te zemrat e njerëzve.
Ai e ka ndier veten të lumtur,
Duke parë nga lart
fushat dhe malet e Atdheut,
Të lara në diell a të thinjura me borë.
Njëherësh i ka therur në zemër
dhe vetvetiu ka zgjatur dorën,
Për të prekur faqet e ashpra të maleve
si fytyrën e plakur të babait,
Ka dashur t'i përkëdhelë me gishta gurët,
T'i bëjë disa shpate më të rrafshata,
Për t'i shtuar fushat...

Njoh një poet të paqetë si lumenjtë.
Nga të gjitha rëniet që ndodhin,
Atë e gëzon vetëm rënia e burokratëve,
Rënia e ziles në derë kur vijnë shokët.
Dhe rënia e shiut të verës
mbi tokën e tharë.
Atë e gëzon vetëm rënia e gjetheve të zverdhura

Nga shkurret e lavdisë së mediokërve,
 Për gjethet e drurëve që rrëzohen në vjeshtë,
 Ia mbush sytë një trishtim njerëzor
 Dhe është gati që xhaketën e tij
 T'ia japë një plepi të zhveshur
 që e dridh erë e ftohtë.
 Asnjëherë nuk i shfaqen në sy pedestale,
 Për të ngritur mbi to statujën e vetvetes.
 Nga të gjitha metamorfozat e mündshme,
 do të pranonte të shndërrohej në një lumë
 Që udhëton pareshtur midis maleve dhe detit...

Njoh një poet të paqetë si lumenjtë.

MESVJESHTË NË PYLL

Të gjitha ngjyrat dridhen
Në bebëzat e vjeshtës.

Tejza të ndera këputen
Në trupin e brishtë
Të një qenieje të qelqtë.

Krisma të thata,
Marramenth gjethesh.

Era lë prapa
Një heshtje të dendur
Si ujë që fle.

Varganë mornicash
Më ngjiten në trup
Si thnegla.

Çapitem ngadalë,
Sikur eci në një shtëpi
Ku dikush është në hijë.



GRINDJE ME FJALET...

Jeni mbyllur brenda si uloke,
Rroni vetëm me dy dritare qiell në ditë,
Ruheni nga rrymat e ajrit, nga e ftohta
E prapë iu dhembin mushkëritë...
Ç'prisni më, fjalë?! Dilni jashtë,
Lidhni rreth qafës shall mjegulle,
Mbështilluni me gëzofin e bërës së bardhë.
Në kokë vini kokore resh.
Mbathni në këmbë çizmet e rrugëve,
Llapashituni me to në llohë e skllotë.
Ngrohni duart te zjarret që ndezin bujqit në fushë,
Te fryma që hukatin në ngricë punëtorët...
Ç'keni që më vështroni të çuditura?!
Pa nisuni për udhë menjëherë,
T'ju rrahin në fytyrë erërat e dimrit
Dhe sidomos erërat e jetës.
T'ju dhembë dhimbja deri në kockë,
T'ju gëzojë gëzimi deri në palcë,
Ndryshe, fjalë, ju ndaloj të dëshmoni për kohën
Dhe jua heq të drejtën e fjalës!

LULE QË ÇELE E PARA

Lule që çele e para,
Lule,
Në këtë ditë me diell,
Lule,
A mendove për borën, për ngricat,
Lule?!
Mbase ti qesh me drojën time,
Lule,
Me urtësinë time njerëzore,
Lule.
Vetëm ti e di kur duhet të çelësh,
Lule,
E di ç'rëndësi ka çelja jote,
Lule,
Në palcë të dimrit, në mes të ngricave,
Lule.
Vetëm ti mund të lulëzosh e të vdesësh,
Lule,
Për dashurinë e një dite me diell,
Lule,
Lule që çele e para,
Lule!

NË TË DALE TË DIMRIT

I kam të uritura këmbët
Për ecje.
Me darën e tyre të madhe
Do t'i mbërthej fort
Rrugët, sheshet.
Largësitë do t'i bluaj
Nën mokrat e shoutave të mia.
Përrenjtë pranverorë
Në damarë më oshëtijnë.
I kam të uritura këmbët
Për hapësira...

PESHA E NJË DITE ME DIELL

Vër në njërën anë hidhërimet e vogla,
Keqkuptimet a grindiet me dikë,
Thinjat e reja që janë shtuar te flokët,
Këpucët e vjetra që futin ujë,
Trishtimin për atë që s'munde të bësh,
Dëshirat që mbetën në mes të rrugës...
Vër në anën tjetër këtë ditë me diell,
Këto pemë të çelura që bëhen shtojzovalle
Kur fliladi i prek në ije me duart e buta,
Qeshjet që flurojnë rreth teje si push plepash.
Atëherë fare lehtë do ta kuptosh:
Kjo ditë me diell peshon më shumë.

NYJË GJAKU

Po çmallem me gurët e vendlindjes.
Edhe ata më njohin, meqë i dua,
E ngado të më shpjerë udha, me vete i marr në sy.
Këtu gjithë të moshuarit
Më thonë: Si je, djali i Markut?
Pakkush e di që kam botuar libra.
Edhe n'ë dittë, as që e zë me gojë.
Më shohin në dritë të syrit kur më flasin,
Ma peshojnë fjalën, siç matin në vjeshtë.
Qengjat motakë, duke i ngritur pezull.
S'duan t'ia dinë në kam ofiq a titull,
Për ta njeriu vlen aq sa i peshon fjala.
Përzihen në bisedë lindjet e vdekjet,
Lagjja, fshati, bota e paanë...
U gëzohen tokës e fëmijëve: gëzime të moçme
Që s'do të plaken kurrë.
Në bebëza kanë vegime dasmash e të korrash.
Zemrat e tyre — folë më vezë pëllumbi.
Sa të kota më duken këto çaste
Iluzionet e lavdisë, smira e shpirtvoglit,
Fraza kritikësh si zjarr me dru të lagura,
A mburrja e akëcilit që pandeh se populli
Vetëm te një libër i tij mendjen e mban...
Pylli përballë shtëpisë ku linda, është rralluar,
Në një shpat tjetër ka mbirë një pyll i ri.
Te pemët ku jam ngjitur si një ketër;

Të thyeja urinë me fruta që dhëmbët m'i mpinin,
Mungojnë shumë degë. Në rrugë mungojnë
Fytyra të njohura që s'do t'i shoh më kurrë,
Takoј fytyra të reja ku rrudha as brenga s'ka,
Ku tipare gjyshërish nëpërduken.
E tillë qenka jeta, i them vetes. Pyll i madh.
Dhe t'i s'je tjetër veç një degë lisi . . .
Që një ditë do të thahet, do të bjerë,
Duke lënë në trung një nyjë. . .
Po, një nyjë gjaku je
Te lisi i jetës që ndër kohëra rritet,
Humb gjethe, degë. svthon e biskon prapë
Te këta gurë, zogj të gurëzuar-malli
Që pas më ndjekin, në gjumë a zgjuar më rrethojnë
Dhe zënë të rrahin flatrat.

DEGA E SHELGUT

Një degë shelgu po më pret
Të bëj prej saj një bilbil,
T'i fryj si në fëmijëri.

Dega pret e pikëllohet,
Mandej mushti trashet,
Mandej gjethet bien.

Nuk jam më fëmijë, moj degë shelgu,
Mos i prit më duart e mia,
As frymën time të ngrohtë!

Por dega çdo prill më pret
Të bëj prej saj një bilbil,
Ta vë në buzët e mia...

Edhe sikur të më harrojë çdo njeri,
Një degë shelgu do të më presë,
Për mua do të pikëllohet.

ÇELËSI

Ja shkolla ime fillore:

Në hapësirën që kanë lënë midis tyre gështenjat,
Duket muri i vjetër, një pjesë e çatisë.

Ajo ngjan me një gjyshe që dremit në diell:
Shkolla e re ia ka marrë të gjithë fëmijët.

Në klasat e saj mbliidhet kruspull heshtja.

Ku është vallë tani shoku im i bankës?

A është më çelësi i shkollës te muri

Ku e linin mësuesit nga qyteti i largët?

Ai çelës që hapte një derë të drunjtë,

Zbulonte para nesh një shpellë me thesare.

Mësuesit iknin e vinin. Ende shumë gjëra s'i kuptoja.

Por sa herë që mbetej çelësi i shkollës në mur.

Diçka sikur ngecte në jetën time

Dhe sa herë që ai çelës kërciste në bravë.

Isha si një orë e madhe që kurdiset. . .

Më vonë kam hyrë në shumë dyer të tjera

Dhe gjithnjë më është dukur sikur ato dyer
m'i hapte

Ai çelës i thjeshtë i shkollës fillore.

Ku do të jetë vallë tani ai çelës?

A mos e kanë marrë në çerdhe laraskat?

A mos e ka varur në qafë si fëmijët

ky diell që perëndon.

Për të hapur me të ditën e nesërme?
Ndoshta po të shkoj tani te shkolla ime,
Prapë do ta gjej te muri atë çelës,
Por a do ta hap dot me të derën e fëmijërisë?!

MAGJIA E BALONAVE TË FËMIJËVE

Fluturake të çuditshme,
Keni shekuj që shëtitni në qiell
Bashkë me farat flatrore, me zogjtë,
Pa menduar të vidhni hapësirën e askujt.
As pulëbardhat, as retë, as yjet
Nuk kanë asnjë grimë mëri ndaj jush.
Asnjëherë s'keni mbajtur mbi krahë bomba
Për të djegur pyjet, për të rrafshuar qytetet,
Ju u pikëlluat kur dogjën me atom Hiroshimën,
Mbajtët zi për fëmijët e vdekur...
Fluturake të çuditshme,
Të ngarkuara vetëm me fantazi fëmijësh,
Ju keni zbritur prej kohësh në hënë,
I keni populluar me jetë e njerëz planetet,
Më parë se të zbuloheshin ligjet e fizikës,
Më parë se të ndërtoheshin raketat.
Do të vjetërohen tipat e avionëve,
Konstruktet metalike do t'i bëjë ndryshku
Ju do të mbeteni magjepsëse si sendet përrallore,
Kurrë s'do të plaket trupi juaj i thjeshtë,
Balona të pafajme si ëndrrat e fëmijëve,
Bishti juaj i hijshëm që dridhet në erë,
Do të zgjatet në qiell si një shkrim magjik...

DJALI UDHËTON

Djali është nisur.
Vetëm këmisha dhe trikoja që ka hequr.
Janë ende në shpinëz të karriges.
Sa të tepërta më duken duart
Që s'i zgjat për t'ia prekur flokët:
Balona të ngecura në tela,
Degë molle të mbetura pa kokrra.
Sa i kotë më duket zëri
Që s'e përdor për të folur me tim bir,
Për t'i thënë thjesht: «Ku luajte?»
Për ta pyetur: «A i bëre detyrat?»
Sa e ftohtë është dhoma,
Shpellë mali, lumë i ngrirë!
Më kot mundohet ta ngrohë
Dielli i kësaj dite dimri.
Sa e zbrazët është shtëpia!
Zëri i djalit sillet në ajër
Si një zog i tejdukshëm,
Për të mos e lënë heshtjen
Të bjerë mbi sende si pluhur.
Nga padurimi për kthimin e tij,
Gjithçka është shtangur në pritje:
Doreza e derës, karriget, tryeza,
Librat në çantë, lapsat me ngjyra...

Tani djali udhëton.
Pas disa ditësh do të kthehet.
Siç vjen prilli në pyllin e zhveshur.
Të buisin prapë rrëké. zëra zogjsh.

Ë N D Ë R R

Isha një genie gjysma prej mishi, gjysma prej ere,
Fare lehtë mund ta mbaja një mal në pëllëmbë,
Siç mban fëmija një luleshqerrë të këputur.
Në lëkurën time rritej tërfil bjeshkësh,
Në vend të gjakut në damarë më rridhnin melodi.
Gurët e rëndomtë i ktheja në ar,
Në gjirin e shkëmbit të thatë nxirrja një burim.
Brenda një dite bëhesha fëmijë, plak, i marrë, i urtë.
Pengohesha pas një kokrrize rëre,
Kapërceja nëntë male sa çel e mbyll sytë.
I ftoja lumenjtë të uleshin këmbëkryq rreth meje,
I bindja grunjërat të rriteshin deri te hëna.
I mashtroja si plaka të verbra pleqërinë e vdekjen:
Nga hidhërimi ato hanin gjunjët e tyre.
I mbyllja engjëjt në kisha të lexonin Ajnshtajnin,
Priftërinjtë i emëroja ciceronë në muzeun ateist.
I dëboja shkëncëtarët nga laboratorët e armëve
Dhe i lija në livadhe të bënin kollotumba.
I rreshtoja gjeneralët në një lirishte pylli
Dhe i vija të komandonin vetëm milingonat.
I mbaja erërat në dorën e djathtë
Dhe i lëshoja vetëm për të pjalmuar drithërat.
I mbaja shirat në dorën e majtë
Dhe i lëshoja vetëm kur më thoshte bari.
E mësoja borën të mos rrokulliste kurrë ortekë.

Ngjitesha në majë të një mali,
Me gjakun tim shkruaja në kupën e qiellit
Dashuri, dashuri, dashuri...
Këto fjalë shndërroheshin në diej të rinj.

MRIZI I LARGËT

Një mriz vjen nga bjeshkët e larta,
Trupon shëtitore, sheshe, udhëkryqe,
Pa u përplasur me kalimtarët,
Pa u hutuar nga makinat zjarrfikëse,
Nga autobusët, veturat e dasmave...
Ky mriz më kërkon mua,
Me hijen e blertë më mbështjell,
Më sjell piskama pipëzash, gurgullima gurrash,
Ma filladit fytyrën me fëshfërima fletësh.
Zheg zhuritës djegaguri.
Mrizi i blertë për krahu më tërheq,
Të më çojë në bjeshkët e larta,
Atje ku bora fshihet nëpër guva
Si një nudo që druhet nga sytë e bjeshkëtarëve.
Një vajzë që nuk plaket kurrë,
Vë në qafë një vargua me rruaza ahu
Dhe qesh si e Bukura e Dheut.
Kambanat e përmbysura të luginave mbushen
Me thirrje barinjsh, me blegërima delesh...

Më fal, mriz i blertë, nuk vij dot me ty:
Në orën dymbëdhjetë kam një mbledhje
Dhe kushedi kur do të dal.
Më duhet të mbaroj patjetër
Variantin e përpunuar të skenarit...
I trishtuar largohet mrizi i blertë,
Kthehet prapë te bjeshkët e larta.

NË TË GDHIRË DËGJOVA SIRENËN...

Në të gdhirë dëgjova sirenën e fortë të trenit
nëpër gjumë:
M'u duk sikur më thirrën të gjitha rrugët
ku nuk munda të eci,
Të gjitha viset që s'do të mundem t'i shoh kurrë...

Ajo sirenë ishte zëri i tyre i largët,
Që fluturoi në qiellin e mendimeve të mia
si pëllumb.

Dhe nuk munda të fle më,
Nuk munda!

NJË GUR MË KËRKON...

Një gur më kërkon që nga lindja ime:
Më kërkon fytyrën, emrin, zërin,
Kërkon të më japë heshtjen e tij,
Që është lodhur duke e mbajtur mbi supe,
Të më japë trajtën e tij të ashpër,
Ftohtësinë prej guri...

Një gur më kërkon që nga lindja ime.

Mbase gurët e kalldrëmit ku eci,
Apo muret e shtëpisë ku fle,
Dyert që hap, shkallët ku hip e zbres,
Dega ku këput një kokërr mollë,
Trëndafili ku pres një bisk,
Era që më than djersën në sjetulla,
Bari i lëndinës ku shkrihem,
Adresën time ia tregojnë fshehurazi.

Një gur më kërkon që nga lindja ime.

Duke rraguar gjithë jetën,
Mundohem t'i iki gurit që më kërkon.
Kur pandeh që është më larg se asnjëherë,
Apo mendoj që i kam dredhuar,

Diellë
për t'u plakur
ngadalë

Guri përgjon aty afër.
Ballë për ballë me të do të ndeshem një ditë,
Takimi ynë është i pashmangshëm.

Një gur më kërkon që nga lindja ime.

Në këtë lojë të gjatë me gurin,
Në këtë dyluftim të heshtur,
Në të vërtetë guri është i humbur.
Qysh nga çasti që ne do të takohemi,
Ai gur s'do të ketë më të drejtë të lëvizë,
As fëmijët me të s'do të lozin...
Ai gur do të jetë kipci im,
I nënshtruari im.
Qysh nga ai cast nuk do të gurojë më,
Do të njerëzojë.

Dietë
për t'u plakur
ngadalë

I THEM VETES

I them vetes: mos u mburr,
Në qenke më i mirë nga i ligu.
Fundja, nuk është thjesht merita jote.
Ti je vetëm grimcë e një të tëre,
Që pareshtur ndeshet me të keqen,
Pjesë e një force që rrjedh vit pas viti
Në venat e tua tok me gjakun.
Fundja, ti je një brumë i mbrujtur
Nga duar të vdekura, nga duar të gjalla,
Që vunë tek ti nga mirësi e tyre.
Fundja, ti je pikërisht ky që je,
Se të tillë të bënë koha, vendi yt,
Ndaj mos u mburr, siç nuk mburret fruta
Që është e ëmbël, e ardhangët.
Ëmbëlsinë fruta e ka nga toka,
Nga dielli, nga rrënjët, nga dega që e mban

NGUJIM MODERN...

Sa herë që gjendem ballë për ballë
me këta njerëz,
Më vijjnë në mend kullat e ngujimit:
Si gjakësit e dikurshëm,
Ata më kanë vrarë kushedi sa orë të jetës
Me mbledhje pa bukë, të mërzitshme,
Me mbledhje të gjata tërkuzë,
Që m'i lidhnin mendjen, duart, këmbët
E më mbanin të gozhduar në vend si mumje.
Gjatë asaj kohe ndjeia keqardhie
Për ato copëza rinie të ikura kot më kot.
Gjatë asaj kohe mund të isha shtrirë në bar,
Duke ëndërruar me duart nën kokë.
Mund të kisha lexuar disa faqe nga Homeri,
Mund të kisha shëtitur nëpër pyll,
Mund të kisha hyrë në një sallë koncerti
Për të dëgjuar Moxartin a një fyell bariu.
Mund të kisha shkuar në një ekspozitë,
Ose mund të kisha shfletuar një album me piktura.
Mund të isha njohur me një njeri të mençur
Dhe fjalët e tij s'do t'i harroja kurrë...
Edhe po të mos kisha bërë asnjë nga këto gjëra.
Prapë do të kisha bërë diçka më të dobishme,
Sesa të më mpiheshin të ndenjurat
Duke dëgjuar fraza të zbrazëta si tullumbace të fryra.
Për atë kohë që kohëngrënësit ma vranë,

Për ato gjëra të bukura që dot s'i shijova
Gjatë atyre orëve të humbura,
(Sa do të bëheshin vallë,
Po të ktheheshin në ditë, në javë, në muaj?),
Për ato punë që kurrë s'i mbarova
Për shkak të tyre,
Për atë pjesë jete që ma ngujuan
në salla me (pa) tym duhani,
Gjakës modernë i quaj me gjithë shpirt...
Edhe nëse shpeshherë kohën më vranë,
Ata nuk mundën të vrasin kurrsesi
Urrejtjen time për burokratët,
Këtë poezi që tek unë një jetë të tërë u ngjiz.

PEMËT GJEOMETRIKE

Sipas Brehtit

Pemë të krasitura rregullisht,
Pa asnjë degë më të gjatë se të tjerat,
Me atë lartësi që ka dashur krasitësi.

Pemë pa degë të kapërthurura,
Pemë pa asnjë degë të tharë,
Pa asnjë degë të shqyer nga furtuna.

Pemë pa asnjë folë në degë,
Sikur të mbajturit e folesë së një zogu,
Të ishte më e madhja kurorëshkelje.

Pemë të krasitura në trajtë veze,
Piramide, kubi e kërpudhe...
Përse djallin e quani veten pemë?!

FRUTË E KALBUR

S'besoj të ketë pasur a të ketë në botë
Ndonjë pemë pa një frutë të kalbur...
Frutë e kalbur në pemën e jetës sonë
Është një njeri që do të kisha dashur
Kurrë të mos ia shihja sytë.
Nuk besoj të ketë gjë më të shëmtuar
Sesa sytë e këtij njeriu.
I njoh mirë: kaq herë janë ngulur mbi mua,
Siç ngulet thika në kurriz,
Siç ngulet në lëndinën me bar
Kazma e varrmihësit.
Janë sy që u mësuan të gëzohen
Me dështimet, me fatkeqësitë e të tjerëve,
Dhe të qeshin siç vezullon natën fosfori
Në varrezat e vjetra e të shembura.
Janë sy që picërrohen
Si sy kukuvajke
Nga sukseset e shokëve,
Nga të ecurit e jetës që pa mëshirë e lë prapa...
Këta sy janë për mua
Njëfarë stacioni meteorologjik:
Kur mrrolen dhe erren si një qiell i mugët,
Them me vete: «I paskam punët mirë!»
Kur vetëtima qeshjesh u lodrojnë në bebëza,

Ndiej të therura në shpatull...
Era e kohës fryn nëpër degë,
Luhat frutën e kalbur:
Prit kur të bjerë!

ME THOTË NJË KRYEARTËZ...

«S'do të kem kohë kurrë
Për të bërë fluturimin e sotëm,
Që e shtyva,
Apo nga i cili hoqa dorë
Për t'u prehur në degën e gjelbër.
Nesër prapë do të fluturoj,
Por fluturimin e shtyrë,
Apo fluturimin nga i cili hoqa dorë,
S'do ta bëj më kurrë:
Fluturimet që nesër do të bëj,
Do të jenë vetëm fluturime të nesërme...»
Më thotë një kryeartëz
Që cicëron majë një peme.

GROTËSK

Në një vit që s'është shënuar në histori,
Një njeri që s'i dihet emri,
Krijoi një aparat elektronik
Për të dozuar saktësisht sasinë e shqetësimit,
Që të mos ia dëmtonte shëndetin.

I lumtur sa më s'ka nga ky aparat,
Ky njeri merrte çdo ditë
Doza të papërfillshme shqetësimi,
Ndënjëherë nuk merrte fare,
Duke menduar se kështu ishte më higjienike...

Nga përdorimi i gjatë i këtij aparati
Dhe sidomos nga të mbajturit e çelësit
Më së shumti te zeroja,
Ndiijat e këtij njeriu u rrëgjuan ngadalë,
Iu pakësuan në minimum ndjenjat.

Madje ky rrëgjim u bë kaq i përkryer,
Saqë ky njeri s'kishte më nevojë për aparat:
Gjithë nervat që dikur përcillnin shqetësimet
Në kokë, në zemër,
I dergjeshin në trup si leshterikë të tharë.

Megjithatë për çdo të papritur,
Apo për ndonjë rikthim të mundshëm
Të aftësisë për t'u shqetësuar,
Ky njeri i lumtur e mbante aparatën me vete,
Në një xhep të padukshëm,
Diku midis kokës e zemrës.

A ishte njeri i lumtur, vallë,
Apo njeri i vdekur?

POTKOI

Duhej të flisje patjetër, nuk fole.
Fjalët që s'i the ti, të tjerë i thanë.
Ti dole nga mbledhja kokulur
me një peshë të rëndë në kraharor:
Pesha e fjalëve të pathëna.
Në rrugë, në shtëpi, në shtrat
Ai rëndim në kraharor nuk t'u hoq...

Dhe ti pe në ëndërr atë natë
Një kalorës të rrëzuar në fushën e betejës,
Që e shkeli kali i zi i kundërshtarit.
Plagët e përgjakura të kalorësve të tjerë
u lidhën,
I morën baladat, gojëdhënat:
Vetëm plagën e kalorësit të rrëzuar,
të shkelur nga kali i kundërshtarit,
Nuk e lidhi asnjë dorë,
Askush nuk e përmendi...

T'u zu fryma nga ankthi, diersët të dolën:
Ai kalorës kishte fytvrën tënde!
Disa kohë të rëndoi ajo peshë në kraharor,
Sikur të mëshonte vërtet potkoi i një kali.
Fjalët që ti s'pate burrërinë t'i thoshe,
Të tjerë i thanë.

QIPARISAT E HESHTUR

Çfarë përpiqen të vizatojnë në qiell
Këta penela që përdorin vetëm një ngjyrë
Në të katër stinët e vitit?

Mos vallë vijnë retë dhe i fshijnë
vizatimet e tyre,
Apo zogjtë i marrin në sqep,
I çojnë në një vend që e dinë vetëm ata
E që s'na e tregojnë kurrë?!

Qiparisat e heshtur rrinë trupdrejtë
Si profetë biblikë.
Pëshpëritin pa pushim midis erërave,
Por të vërtetën e tyre ende s'e mësuam.

Ndoshta ua thonë vetëm varreve...

SERIOZITETI I FËMIJËVE

Ata luajnë në oborr... Për fëmijët
Nuk ka asgjë më serioze se loja e tyre.
Imitojnë punët, veprimet e të mëdhenjve.
Jepen pas lojës me mish e me shpirt.
Djersijnë. Qajnë nga inati. Ia shkrepin të qeshurit.
Asnjëherë s'e pranojnë humbjen,
Siç nuk e pranon ngjyrën e zezë ylberi.
Ëndërrojnë për bëma të mëdha e të mrekullueshme.
U skuqet fytyra, ulin sytë kur ndodh që gënjejnë.
Luajnë pa e ditur se kjo lojë që i rrit,
Është ura që i çon te bota e të mëdhenjve...
Sa të vegjël janë para seriozitetit të tyre
Të rriturit që punët i marrin lehtë e lehtë,
Ata që kanë hequr dorë nga ëndërrimet
Dhe janë ftohur si një yll i vjetër,
Ata që janë mësuar me dështimet, me thyerjen
e ngadalshme,
Që nuk skuqen më, nuk ulin sytë kur gënjejnë.
Ata që djersijnë vetëm pranë stufës ose në plazhe,
Që mbahen seriozë për të fshehur mungesën
e seriozitetit,
Ata që e kanë ndërgjegjen si letërthithëse
të përdorur,
Që nuk mendojnë seriozisht për jetën,
as për vdekjen...
Fëmijë të mirë që luani kaq seriozisht në oborr,
Kurrë mos u bëfshi si këta njerëz!

GRERËZAT

Për epigonët

Hojet e tyre s'kanë të sharë,
Përsosmërisht i ndërtojnë, krejt si bletët,
Por në to — asnjë pikë mjaltë.
Rrojtën dje, rrojnë sot,
Do të rrojnë mbase dhe nesër
Me mjaltë të vjedhur tinëzisht.
Hojet e tyre — zgavra të zbrazëta.
Të fshehtën për të bërë mjaltë
Vetëm bletët e dinë:
Grerëzat kurrë s'kanë për ta mësuar,
Si murga rreth zgjojeve do të sillen.

ENGJËJ....

(Në muzeun e artit mesjetar)

Engjëj,
Zogj të gjorë që kurrë s'fluturoat,
Flatrat tuaja ua vodhët njerëzve...
Me flatra të vjedhura?!
Engjëj,
Zogj të gjorë që kurrë s'fluturoat,
Koha ime ua shkuli flatrat,
Mbushi me to jastekë të mëdhenj,
E si mund të ngjiteshit në qiej,
Të paktën sa një gushëkuq,
Të mbështeste aty kokën pa ankthe
E të shihte vetëm ëndrra të kthjellëta.
Engjëj,
Zogj të gjorë që kurrë s'fluturoat
Dhe s'e dehët kurrë kraharorin me qiell,
Si dënim për vjedhjen e flatrave të huaja,
Të gozhduar në mure do të mbeteni
Simbol i fluturimeve të rreme!

PËR NJË LIBËR

Më qan zemra për një libër
Që s'kam ku ta gjej,
Siç i qan zemra gurrës pa ujë për një curril
Dhe pyllit në korrik për pakëz erë.

Atë libër e ka në bibliotekën e tij
Një njeri që s'do ta lexojë kurrë.
Si lënësja do të plaken fletët e librit,
Duke pritur duart dhe sytë e dikujt...

Por fundja kam diçka që s'mund ta ketë assesi
Ai pronar librash që unë kurrë s'do t'i gjej:
Gjithmonë ka qenë më shpirtpasur
një njeri që kërkon dashurinë,
Sesa mbreti që zotëron një harem.

NARCISOIDI

Pandeh se toka
Nuk sillet rreth boshtit të saj,
Po rreth shtyllës së tij kurrizore.
E sheh jetën nga lart,
Sikur është ulur mbi një re.
I sheh të tjerët nga larg,
Sikur po shëtit me hënën në duar
Në brigjet e mijëvjeçarit të ardhshëm.
Gjithë kohën qëndron i përkulur
Mbi pusin e vetvetes.
I gjori, nuk e di:
Edhe këmishën që ka veshur,
Edhe këpucët që ka mbathur,
Edhe cigaret që pi,
Edhe bukën që ha,
I ka nga të tjerët...
Kini mëshirë për të,
Hiqjani atë mjegull nga sytë,
Para se të fundoset në pusin e vetvetes
E të mbytet!

SHPEJTËSITË

Në fillim njeriu eci me dy këmbët e tij
Që i mbështeste fort në tokë,
Gjithnjë në kërkim të lumturisë
Dhe të një njeriu tjetër
Me shpirt si ai.
Mijëra vjet më vonë zbuti kalin,
Shpiku lundrën me rema, anijen me vela,
Me të cilat u krijuan epopetë e mëdha.
Pastaj njeriu shpiku rrotën —
Revolucioni i parë në fushën e teknikës.
Më vonë, shumë më vonë
Shpiku makinën e parë me avull,
Trenin e parë, transoqeanikun e parë,
Shpiku avionët supersonikë, satelitët
dhe anijet kozmike,
Mjete me shpejtësi të pallogaritshme...
Mbetet të llogaritet sa iu afrova
njeriu lumturisë
Që nga koha kur ecte vetëm me dy këmbë,
Sa u shkurtua largësia
Midis tij dhe një njeriu tjetër
Me shpirt si ai.

DORËSHKRIMET

Kaloj nëpër duar dorëshkrime.
Dorëshkrime të zverdhura.
Dorëshkrime të shkarravitura.

Gris fletë.
Gris radhorë me vija, pa vija.
Krrau-krrau,
Krrau-krrau! . . .
Krrakavit korbi bardhezi i dorëshkrimeve.
Gris ditë e net.
Gris javë, muaj, vite.
Në shportë bien një nga një
Pendët bardhezi të korbit të dorëshkrimeve.
Krrau-krrau,
Krrau-krrau! . . .
Sa pak gjëra i bëkan ballë grisjes!
Kaloj nëpër duar dorëshkrime.
Dorëshkrime si vajza të mbetura.
Dorëshkrime — dështime.

Pa dhimbje i gris
Si pema që hedh gjethet e verdha
Në emër të sythave që do të lindin.
Krrau-krrau,
Krrau-krrau! . . .
Krrakavit, korb i ngjirur, krrakavit,

Vajto për pendët e tua të mjera,
Të mbushura me mendime e fjalë të grisura,
Jeta ime nuk është dorëshkrim i keq,
Unë qesh me to si feniksi me hirin!

I FRIKSHMI

Ai nuk ka gjak në damarë:
Ka frikë.
Në kraharor ka një kambanë
Që kumbon ankth.
Ai e përhap frikën
Si murlani të ftohtit.
Filozofinë e të qenit brenda
E ka shndërruar në guaskë të fortë.
Ai i përfytyron lumenjtë
Vetëm të mbuluar me akull.
Po ta kishte në dorë,
Do t'i quante të paligjshme ujëvarat.
Po t'i bindeshin atij,
Bajamet do të lulëzonin vetëm në verë.
Pas veshit ka të ngjitur
Telefonin e frikshëm të shefit.
Sa herë që kyç derën e zyrës,
Mbi karrigen e lëmuar nga të ndenjurit,
Lë hijen e tij të ulur galuc.
Natën sheh ëndrra të liga,
Sikur karrigia e zyrës bëhet kalë i tërbuar
Dhe e hedh në greminë...
Ai ka frikë
Nga guximi i të tjerëve:
Gjithmonë i ka munguar burrëria:
Frikën dhe mediokritetin e tij

I bën kut të çdo mendimi,
Gërshërë për çdo risi.
Është e pamundur të ecësh përpara,
E pamundur të ngjitesh,
Pa shkelur mbi mediokritetin,
Mbi kufomën e frikës së tij!

VARGJET E RONITURA...

Honoraret e tyre (jo të vogla) u bënë shkumë birre,
Pasta për të qerasur vajzat çapkëne,
me të qeshura kumbuese si turfullima mëzi,
U bënë pallto të ngrohta,
të qepura sipas modës së fundit,
Këpucë me porosi që vallëzuan me virtuozyt
mbi pllaka mermeri, mbi parkete të lëmuara.

Poetët e vërtetë shitnin latën e darkës
për të parë një film të ri,
Fërgëllonin dimrit në auditoret e gjera,
Në korridore linin prapa si një bisht komete
kollitje të ngjirura
Dhe si në baladat romantike, në rrugë i ndiqnin pas
gjysmëhënat e shojeve të ngrëna...

Tani vargjet e ronitura dergjen nëpër koleksione,
Të grimuara nga vitet me një shtresëz pluhuri,
Të rreshtuara në rafte bibliotekash
si qivure të vogla.
Po autorët e tyre që zinin në gazeta
vendet më të dukshme,
Që kritikët ua hidhnin emrat si zare

Në shkrime më të gjata se largësia Tokë-Hënë,
Që ishin të përpiktë në ditën e marrjes së honorareve
si në takimet më të dashurat,
Ç'u bënë?!

DIETË PËR T'U PLAKUR NGADALË

Meqë pleqëria nuk bën asnjë përjashtim
Për sendet, gjallesat, njerëzit,
Për t'u plakur sa më ngadalë që të jetë e mundur,
Mbaj këtë dietë:

E para, bëj gjumë pa ëndrra të liga,
Gjumë të thellë e të qetë si shqerrë,
Ngaqë s'më vret ndërgjegjja për ndonjë poshtërsi,
Ngaqë nuk vras mendjen të bëj ligësira të nesërmen
Dhe asnjëherë nuk ma nxjerr gjumin në pikë të natës
Lakmia për pozita, për ndere.

E dyta, që të më plaken sa më ngadalë

Trupi dhe shpirti,

Çdo ditë pi musht urrejtjeje,

Siç i pinë lulëkuqet në rrafshinë

Kupat e tyre me vesë.

Pi urrejtje për keqbërësit, për padrejtësitë,

Urrejtje për atë që të keqes i hap udhë,

Urrejtje për atë që s'i urren të ligjtë

Në çdo cep të rruzullit.

Pi urrejtje për gënjeshttrat, për kotësitë,

për plogështinë,

Urrejtje edhe për atë pjesë të vetvetes

Që nuk është thelbi im...

Si të kisha pirë qumësht Zane,

Gjaku në damarë më rrjedh më shpejt,

I lëviz më shpejt duart, më shpejt i hedh hapat

Dhe ndiej se pleqëria gulçon prapa meje:
Prej kohësh është vërtetuar nga shkencëtarët
Se shpejtësia dhe plakja janë në raport të zhdrejtë.

Lexues, po deshe të plakesh ngadalë,
Mba këtë dietë.

Dhimbje vëllai

I — THIKA E PËRGJAKUR

...E NË SY U DIGJET MESJETA

1

Në podiume çirren
Liderë fytyrëbishë.

Brenda kafkës mbajnë kurora mbretërore,
Pancirë kryqtarësh veshin nën këmishë.

Mesjeta u del në lëkurë
Si një li e lemerishme.

Si turrat e druve
Mesjeta u digjet në zgavrat e syve...

Për masakra votojnë
Liderë fytyrëkufomë.

Rrëshqasin rrugëve
Tanke, taborre.

2

Ka net kur është shekulli i trembëdhjetë,
Ka ditë kur koha e Inkuizionit gdhin.

Njerëzit vriten nga jonjerëzit
Dhe koha skuqet me gjak fëmijësh.

Dridhen armët kur shtien,
Vetëm duart e vrasësve nuk dridhen.

Ato turma që vërshojnë nëpër sheshe —
Batica lirie...

1989

NDËRRO EMRIN!...

Ndërro emrin, më thonë,
Pagëzohu me emrin që të japim ne,
Shkule gjuhën që ke në gojë,
Vër aty një gjuhë tjetër
E me të fol!
Harro fjalët që mësove në gji të nënës,
Bashkëtingëlloret e tua harroji!

Ndërro emrin, më thonë,
Fol ndryshe nga ç'ndien në zemër,
Fol ndryshe nga ç'mendon!
Ndryshoje fytyrën që ke,
Edhe nga shpirti yt hiq dorë:
Flake shpirtin si këmishë të vjetër.
Me shpirtin që të japim ne, zëvendësoje!

Ndërro emrin, më thonë,
Ndryshe s'të lëmë as një gllënikë qiell,
S'të lëmë as një kafshatë tokë!
Edhe frymën që merr, do të ta ndalim,
Hisen e diellit do të ta sekuestrojmë!

Ndërro thelbin tënd, më thonë,
Buzëqesh vetëm me urdhër,

Vetëm me urdhër nxirr lot!
Këndo vetëm këngët që dimë ne,
Shpreh vetëm mendimet që kemi ne në kokë!
Kur heshtim ne: hesht!
Kur të japim shenjë ne: fol!...

Në do të bësh hije mbi tokë,
Ndërro emrin, ndërro emrin, ndërro emrin,
Më thonë.
Unë vdekjen time s'e nënshkruaj!

E TI I THE

... e ti i the:

Të plaçin sytë e ballit,
Mos ma shkel hijen rrugëve,
Mos ma shkel varrin e babës,
Mos ma shkel arën që e mbolla me grurë!

... e ti i the:

T'u thaftë gjuha në gojë,
Mos ma shaj gjakun e stërgjyshit.
Mos ma shaj nusen me foshnjë në dorë,
Mos m'i shaj fjalët e mia!

... e ti i the:

T'u rrënoftë varri,
Mos m'i shkul hardhitë e pemët,
Mos ma shkul caranin e vatrës,
Mos ma shemb harkun e derës
Ku kam gdhendur diellin!

... e ti i the:

Të humbtë emri,
Mos ma moho emrin tim,
Këtu edhe guri më thërret në emër,
Edhe lumenjtë gjuhën ma dinë,
Edhe zogjtë e qiellit kanë emrin tim!

TË RROSH NË KËMBË

Të tjerë ndërtonin për vete piramida.
Të tjerë ngrinin obeliskë, harqe triumfi. . .

Ti luftoje për t'u mbajtur në këmbë,
Piramidat i ndërtoje brenda vetes.
Obeliskët i ngrije në shtyllën kurrizore.
Harqet e triumfit — me këmbët e ngulura
në truall.

Rivalizojë pingulsinë e maleve,
Pingulsinë e plepave e të pishave
Me drejtqëndrimin tënd.

Plotësoje qëndresën e kullave,
Pathyeshmërinë e kështjellave
Me mosgjunjëzimin tënd. . .

Gjithë jetën në mospajtim me shpinëkërrusjen.
Në dyluftim me kokukurit, me gjunjëprerët.

Të rrosh në këmbë —
Përvoja dhe ngadhënjimi i shekujve.

KËSHTJELLARI

Edhe ti je kështjellar, më beso.
Ku është kështjella? më thua. Po kullat? Bedenat?
Kuptoje që kështjellën e ke në vetvete,
E ke në eshtra, në nerva, në gjak, më beso.
Atë e ngritën me mundim stërgjyshërit e tu,
Më tepër se kraharorin dhe kokën e mbrojtën.
Gjithë kështjellat prej guri qenë hije e së parës,
Imitim i kështjellës që kishte njeriu në vetvete.
Ku i kam armët? më thua duke hapur pëllëmbët.
Asnjeri nuk e bënë kështjellar vetëm armët,
Por dhe ti nuk je duarzbrazët, me beso.
Rëndësi ka të zotërosh ato armë që ke.
Ku janë hordhitë? më thua. Po topat e tmerrshëm?
Ajri dridhet rreth teje nga zhurmat e tyre.
Për atë që kupton, çdo ditë është betejë.
Shih si i shkëlqejnë sytë e ligj kundërshtarit,
Kur ta vë shpatën në fyt, ta shemb tokën nën këmbë,
Me bllokadë të pamëshirshme përpiqet të të mbytë.
Kasnecët mashtrojnë; koha e paqes është larg.
Kurrë nuk pati më shumë pabesi, kurthe, intriga.
Është e kotë t'i numërosh tërë plagët që merr.
Dije se kjo kohë ka brenda saj disa kohë,
Siç ka një njeri në vetvete shumë njerëz
Që janë zanafilla dhe arketipi i tij.
Ti je vetëm erë pa kështjellën që ke në vetvete...
Edhe ti je kështjellar, më beso.

KORBI I LASHTË

Ai tund kokën si një kabanë të përmortshme,
Shënon diçka bri emrit tim:
Maja e penës bëhet sqep korbi,
Zë të më çukitë sytë,
Të më çukitë në sy imazhin e së dashurës,
Një hënë maji që ka mbetur aty.
Zë të më çukitë në buzë qeshjet, fjalët,
Zë të më çukitë mishin, eshtrat,
Njeriu që bën shënime bri emrit tim,
Duke gërvishtur letrën me majën e penës.

Kështu, pa iu dridhur fare dora,
Vendos dhe nënshkruan groposjen time
Ai: dreqi, kryeengjëlli, kryezoti
Që mendon se ka mbi mua
Po aq të drejtë sa ç'ka krimbi mbi gjethen,
Po aq të drejtë sa ç'ka breshri mbi kallëzën,
Po aq të drejtë sa ç'ka thundra e buallit
Të shtypë në kullota një thnegël. . .

Sytë e mi, eshtrat e mia të moçme
I kanë çukitur korbat 99 herë,
Në 99 kroje, në 99 kodra,
Në 99 male i kanë çukitur.

Rrasën e varrit e kam hedhur mënjanë,
Mbi tokën time në këmbë jam ngritur,
Jam larë me vesë livadhi,
Kam pirë rreze dielli, ujë burimi,
Kam marrë dy yje në qiell,
I kam vënë në zgavrat e syve,
Në udhën time kam ecur,
Shqipes shqip i kam thirrur. . .

E korbi korb ka mbetur!

E URREJ ATË NJERI...

Për një shovinst

Nuk e urrej thjesht ngaqë më urren.
Nuk e urrej vetëm ngaqë ditë e natë
përpiqet të më bëjë të zezën.
E urrej sepse hija që ai lëshon mbi dhé,
Është fyerje për diellin.
E urrej sepse dritën që ai vjedh,
Mund ta merrte një lule, një gjethe.
E urrej sepse ajri që ai thith,
Mund të shkonte në mushkëritë e një shpendi,
Mund të bëhej në gushën e tij cicërimë.

E urrej atë njeri, e urrej...

Ne jemi të papajtueshëm
Si drita dhe errësira.
Si uji i kthjellët dhe uji i turbullt,
Si zjarri dhe ngrica,
Sepse gjithçka që besoj dhe dua unë,
Ai e quan të keqe, pa vlerë.
Sepse gjithçka që beson dhe do ai,
Është çnjerëzore, e gënjeshtërt.
Midis nesh kalon një kufi
Si vija që ndan buzët e të vdekurit...

E urrej atë njeri, e urrej!

BURRAT E DHEUT

Këta burra të ngjuar në zemër të dheut,
Këta burra të varrosur për së gjalli,
Që të mos ua murosin jetën dhe emrin
Në muret e zeza të miteve mesjetare,
Këta burra stoikë, këta Atlantë zemërmëdhenj,
Ia kanë vënë shpatullat dheut të tyre:
Pa ato shpatulla trualli do t'u shembej.
Do t'u rrëzohej mbi kokë qielli me yje.
Këta burra të ngjuar në zemër të dheut,
Me buzë të rreshkura, me mushkëri të zhuritura:
Në trupin e tyre sfilitet njeriu i çdo vendi,
Lirisë së çdo njeriu i zihet fryma.
Këta burra të ngjuar si kreshnikët e lashtë,
Si shtatore dardane të groposura nga tërmetet:
Ti, botë e madhe, plot galeri arti,
Eja dhe përkulu te këto galeri qëndrese!
Mbi shpatulla u rëndojnë shkëmbinjtë e heshtur,
Një mijë herë më shumë u rëndojnë mospërfilljet.
Në sytë e tyre ku regëtin drita e mekur,
Agon një diell që do t'ua lënë fëmijëve.
Ata e mbajnë dheun e tyre mbi shpatulla,
Me të mbi shpatulla po ecin nëpër botë,
Me të mbi shpatulla do të ecin pa u ndalur
Për ta çuar te liria dhe nderi njerëzor.
Këta burra të ngjuar në zemër të dheut,

I lind dheu për së dyti si në besimet pellazge¹),
Për të hyrë sup më sup në histori dhe poema,
Me ato kasketa të thjeshta si përkrenare.

1) pellazg = i lindur nga dheu

LETRA E DJEGUR ME CIGARE

Zarf i thjeshtë.
Pullë e huaj.
Vulat me stema të dy shteteve...

Letra —
Shkrimi i shtrembër i vëllait,
Disa radhë me fjalë të zakonshme,
Një tufë e zakonshme të falash,
Në mes
Një brimë e djegur me cigare.

Kështu erdhi letra nga larg...

Ajo brimë e errët
Si një gojë e hapur nga fjalë që s'u thanë,
Si një gojë e çuditshme,
Për policët e pakuptueshme,
Ajo gojë e nxirë, me buzë të shkrumbuara
Si goja e atij që e vranë natën,
Si goja e atij që vdiq në tortura —
Ajo gojë e gjëmës së madhe.

Ajo brimë e errët
Thotë: Brima të reja në kraharorët e burrave,
Brima të reja në zemrat e nënave,
Djelmosha të groposur nën rrënjët e drurëve,
Gojë të mbushura me dhé,
Sy ku e varrosën të gjallë edhe hënën.

Ajo brimë e djegur —
Grykëderdhje lotësh të gëlltitur,
Rënkimesh të ndrydhura, betimesh të heshtura;
Grykëderdhje e fatkobit, e dhimbjes krenare;
Grykëderdhje e urrejtjes
Dhe e mallkimit që s'fal...

Ajo letër e djegur me cigare!

TRËNDAFILAT E BARDHË

*Vriten edhe fëmijë
nëpër demonstrata...*

(Nga shtypi)

Edhe këtë pranverë, athua se s'ka ndodhur asgjë,
Atje çelin në kopshte, trëndafilat e bardhë.
Po si është e mundur vallë, si është e mundur,
Që edhe këtë pranverë të ketë trëndafila të bardhë?!
Pas gjakut që u derdh në këmishët e fëmijëve,
A mund të jenë të bardhë trëndafilat e bardhë?
Kur rrugë e sheshe skuqin nga gjaku i pafajshëm,
Të çmend marrëzia e trëndafilave të bardhë.
Ke dëshirë të zotërosh një fuqi të mbinatyrshme,
T'i fshehësh prapë në sytha trëndafilat e bardhë!
Si nuse të veshura me të bardha që shkojnë në varrim,
Ngjajnë këtë pranverë trëndafilat e bardhë.
Jo, nuk mund të harrosh gjakun e të vrarëve,
S'i sheh dot me sy trëndafilat e bardhë!

BALLABAN PASHËS

Thonë se një ditë
Ta bënë gropën në Krujë:
Unë kurrë s'e kam besuar.

Të kam parë nëpër shekuj
Të gjunjëzuar para sulltanësh,
Para kralësh e presidentësh...

Edhe sot ti je në gjunjë,
Renegat i gjakut tënd,
I përбетuar kundër nesh.

Prapa penës sate jatagani kërruset,
Prapa kostumit tënd të prerë sipas modës
Xhybja e pashait duket...

Thonë se një ditë
Ta bënë gropën në Krujë,
Por lufta me ty s'ka mbaruar!

THIKA E PËRGJAKUR

Thika që vrau Maratin, udhëton nëpër kohë,
Shkon e vjen nga shteti në shtet.

Kullon gjak mbi netët e ditët

Thika që vrau Maratin.

Godet prapë të tjerë. Godet përditë dikë:

I ngulet në ije, në shpinë, në zverk

Thika që vrau Maratin.

Aty duket e zhduket, aty shfaqet prapë.

Vetëm thika lëviz. Dora nuk shihet.

Dora fshihet pas thikës.

Nga thika pikon gjak.

Gjak i kuq.

Gjaku i Maratit.

Gjaku i revolucionarit. I të ndershmit.

Vetëm thika lëviz. E njëjta thikë.

Dorës nuk i dihet emri,

Se dora nuk shihet.

Vetë thika duket

dhe gjaku

që pikon

nga damarët

e Maratit

të vrarë...

Kraharori i Maratit — shegë e çarë,

Çukitin në të zogjtë e zinj.

ULLIRI I TË SHPËRNGULURIT

Nga gjylet e topit
Ullinjtë copëtuar,
Ata duke ikur
E duke luftuar...

Populli

Ky ulli ka në trung një zgavër të zezë,
Plagë gjylesh që ndiqnin këmba-këmbës
Njeriun e lindur nën atë qiell,
Të mbajtur pas rrënjëve
Si drurët e moçëm,
Të mbirë në shkëmb.
Netëve
Era kafshon gjunjët e gurëve,
Vesa loton në cepat e gjetheve
Dhe zgjohet në zgavrën e zezë të ullirit
Një ulërimë burri,
Gruaje,
Fëmije...
Sillet si shtjellë në zgavër, shpërthen nga degët,
Çan lëvoren e bisqeve të njoma,
Zë të brejë hënën e verdhë,
Të ngecur te kurora.

Plasarit qiellin e bruztë,
Ku shkasin si lot malli
Yj të këputur.
Ajo ulërimë del nga zgavra e zezë.
Kërkon sytë e njeriut
Që la në tokë eshtrat dhe emrat e të vdekurve.
Që la zemrën në degët e ullirit
Dhe me kraharorin humnerë
Udhëve të botës pa zemër u nis!

II — DITAR MËRGIMTARI

RRUGA

Ti je ai gjarpri i çuditshëm
Me kryet në prag të derës
Si në gjëzat e fëmijërisë.

Ti je pejzë e gjallë e mishit tim
Që në çdo ndarje dhemb.

Ti je pejzë e gjallë e mishit tim
Që dridhet nga gazi në çdo kthim.

Ti je gjarpri i trollit që shtëpinë ruan:
Përmes teje largohem prej saj,
Pa u ndarë kurrë.

MËNGJES I DHIMBSHËM

Më ka mbetur në sy
Një mëngjes i dhimbshëm
Si një lot i ngrirë.

Asnjë diell s'do ta shkrijë
Këtë lot.

Si krahnezë
Mbi shpirtin tim
Përherë do të pikojë.

Më ka mbetur në sy
Si një lot i ngrirë
Një mëngjes ngjyrë plumbi...

Larg vatrës,
Tani botën e shoh më të turbullt.

MËRGIMTARI I PAPUNË

Eci në këmbë,
Ha në këmbë,
Fle në këmbë,
Ëndërroj në këmbë,
Pres në këmbë,
Vdes në këmbë...
O natyrë,
Përse më bëre me këmbë?!

PRAPA XHAMIT

Lulet çelin në livadh:
Sikur çelin prapa xhamit.

Zogjtë cicërojnë me ngazëllim:
Sikur cicërojnë prapa xhamit.

Bukuria lulëzon në fytyrat e vajzave:
Sikur lulëzon prapa xhamit.

Të dashuruarit qeshin me të madhe:
Sikur qeshin prapa xhamit.

Njerëzit flasin me njëri-tjetrin:
Sikur flasin prapa xhamit...

M'u gjakosën gishtat së godituri:
Vaj, kur do ta thyej këtë xham?!

NDËRTONI ÇERDHE, ZOGJ...

Ndërtoni çerdhe, zogj,
Flini në to, ëndërroni, bëni dashuri,
Këndoni, kllonitni vezë,
Pikëllohuni në ditët me shi,
Ngazëllehuni në ditët me diell,
Strukuni brenda tyre të mos ju rrahë veriu.
Ndërtoni çerdhe, zogj...
Sot pa keqardhje ju fal
Trajtën time njerëzore:
Cili nga ju është aq altruist.
Sa të pranojë të bëhet njeri në vendin tim
Dhe unë në vend të tij të bëhem zog,
Së paku për një ditë.
Që të shijoj qoftë dhe një ditë të vetme
Kënaqësinë e kthimit në shtëpi,
Kënaqësinë për të ndenjur një ditë të tërë
Me njerëzit e mi?...
Zogj, asnjëri nga ju s'po më përgjigjet?!

MALLI I SHTËPISË

Malli i shtëpisë bëhet më i dhimbshëm në mbrëmje,
Ai të ngashëren me gjuhën e gjërave të thjeshta:
Me erën e kafes së pjekur që përhapet në lagje,
Me kundërmimin e një dorëzonje që zgjatet mbi kangjella.
Me hijen e dy pleqve të ulur nën tendën e rrushit,
Me duart e një nuseje që shtyn karrocën e foshnjës,
Me çarçafët e larë që luhaten në tel nga puhia,
Me zërin e gjyshes që thërret nipin e harruar në lojë.
Llambat ndizen një nga një në rrugën e gjerë,
Nata shndërrohet befas në një mace të larme,
Që të fërkohet pas këmbëve, të pengon të ecësh.
Malli për shtëpinë e largët të mbetet në grykë
Si uji kur pi rrëmbimthi nga të eturit...

HESHTJA MË FLET PËR TY

Heshtja më flet për ty.
Mungesa jote më prek lehtë
Si një dorë e padukshme.
Mendimet që s't'i thashë,
Klithin brenda meje.
Ndjenjat që nuk t'i shpreha,
Flakërojnë brenda eshtrave të mia.
Ditët kur nuk të shoh ty,
Rreshtohen si vargan vajtojcash
Që përcjellin gëzimin e mbyllur në qivur.
Ç'të bëj me këto net kur ti je larg?
Ato më rëndojnë në shpirt
Si dheu mbi të gjallin...

KA ÇASTE KUR I KAM MËRI SYTË E MI...

Ka çaste kur i kam mëri sytë e mi,
Aq sa do të doja të isha pa sy
Si ai që ka lindur i verbër,
T'i kisha sytë si dy puse,
Të mbushur vetëm me përfvtyrimin tënd.
Ka çaste kur i kam mëri duart e mia,
Aq sa do të doja të isha pa duar,
Të mos mund të shtrëngoja me to duar të tjera,
Përveç duarve të tua.
Ka çaste kur i kam mëri buzët e mia,
Aq sa do të doja të isha pa buzë,
Të mos mund të shqiptoja me to asnjë fjalë
Që s'do të ishte për ty,
Të mos mund të lëshoja në ajër të qeshura
Që s'do t'i dëgjoje ti.
Ka çaste kur e kam mëri heshtjen
Që s'mbushet nga fjalët e tua.
Ka çaste kur e kam mëri jehonën
Që s'më sjell mbi flatra zërin tënd.
Ka çaste kur e kam mëri hijen time
Që zvarritet pas meje si nepërkë
Dhe më pëshpërit në pafundësinë e rrugëve:
I vetëm, i vetëm, i vetëm!...
Ka çaste kur e kam mëri trupin tim
Që s'mund të mbështetet te trupi yt,

Siç mbështetet ftoi i lulëzuar tek era,
Për të ndier peshën e dhimbjes, peshën e gëzimit,
Peshën e kohës që ikën e të kohës që vjen,
Peshën e butë e të ngrohtë të dashurisë.

TË KËRKOJ ME SY KUDO...

Të kërkoj me sy kudo dhe s'të shoh askund,
Kam në sy hutimin e njeriut që gjendet një mëngjes
Në një shtëpi shumëkatëshe pa shkallë, pa dyer,
Në një rrugë ku s'dëgjohet asnjë hap,
Në një qytet ku s'banon asnjëri,
Në një livadh ku s'ka mbetur asnjë fije bari,
Në një pyll ku i kanë shkukur të gjithë drurët
Dhe i kanë vrarë të gjithë zogjtë,
Në një rrafshinë të mbuluar me borë të ngrirë,
Ku ecën pa e shoqëruar as hija e tij,
Mbi një dërrasë në mes të detit të dallgëzuar,
Nën një qiell pa re, pa diell, pa yje...
Të kërkoj me sy kudo dhe s'të shoh askund.

ILUZION

Vë përpara një letër të bardhë,
Heq vija me laps dhe bëj muret e një shtëpie,
I vë shtëpisë një çati të pjerrët për të shkarë bora,
Vizatoj dyert, dritaret, shkallët, oborrin,
Në oborr vizatoj plepin ku ndodhet emri im...
E lë lapsin në tryezë, mbështet kokën në pëllëmbë,
Duke vështruar shtëpinë e sapovizatuar,
Ngjit me mend shkallët, trokas në derë:
Te dera e hapur shfaqen fëmijët,
Më hidhen në qafë, kacavaren pas meje,
Mbyllin derën të mos futet brenda të ftohtit.
Heq pallton, këpucët e qullura nga shiu,
Ngrohem pranë stufës ku zien ibriku i çajit,
Qëroj një mollë dhe ia jap sime bije,
Më vonë dëgjoj djalin të më flasë për dardanët,
E ndihmoj të zgjidhë një problemë me trena...
Nata e ftohtë rrëqethet nga fishkëllimat e trenave:
Asnjë nga këta trena s'do të më çojë në vendlindje.
Gishtat më dhembin duke shtrenguar lapsin,
Heq dy vija që priten mbi shtëpinë e vizatuar,
Vë një kryq mbi iluzionin tim.

MERIMANGA

Gjithë natën kishte ndenjtur pa fjetur,
Duke endur rrjetën e saj
Midis shtalkës dhe dorezës së derës.

U drodha,
Kur e pashë atë rrjetë
Si një grackë të kobshme.

Hapa derën me vrull,
Që rrjeta të mos më cikte,
Dhe dola në rrugë.

Vazhdova të ecja,
Për të këputur fijet
E asaj rrjete të tmerrshme...

Merimanga e zezë tirrte kobe të reja!

FJALA AFROHET PRANË FJALËS

Fjala afrohet pranë fjalës
Në letrën e bardhë.

Mundohen të bëhen mur
Përballë heshtjes,
Urë që kapërcen harrimin.

Të bëhen ylber
Mbi dhimbjet.

Dashuria
Në formën e fjalëve
Mundohet të më ngjitë në brinjë
Flatrat e zogut...

Fjala afrohet pranë fjalës:
Ato më ngrohin shpirtin
Si prushi i vatrës së moçme.

ÇDO NATË

Çdo natë
Në ëndërr kthehem te vendlindja,
Pranë vatrës së largët.

Tashti të gjitha ëndrrat e mia.
Kanë formën e rrugëve
Që të çojnë në jug.

Të gjitha mëngjeset
Shndërrohen në rrugë
Që më presin...

Rruga e kthimit —
Mëngjesi më i madh
Me diellin që agon te vatra!

Diejt e ikur

DIEJT E IKUR...:

Dielli që doli mbi mal,
Do të më ngrohë vetëm sot.
Diejt e ditëve me diell
Do të më ndriçojnë vetëm nga mëngjesi
në mbrëmje...

Por diejt e ikur, të çasteve
të mbetura në kujtesë,
Më ngrohini në çdo stinë,
Nuk perëndojnë kurrë.

Sa e ftohtë do të ishte bota,
Sa e mugët,
Pa dritën e diejve të ikur,
të mbetur në kujtesë!

MACJA E LARME...

Një mace e larme rri te këndi i një kthine
e shullëhet në diell.
Në muret e rrënuara s'ka dyer as dritare,
Pllakat e dyshemesë janë të thyera.
Ndalem dhe e shoh gjatë atë mace të larme:
Më kujtohen shtëpia atërore, vatra, gjyshja,
përrallat, fëmijëria...
Më duket sikur ajo ndërtesë e qëmotshme
është vetë shtëpia ime atërore
Dhe ajo mace e larme që rri te këndi i një kthine,
E rrethuar nga heshtja e rrënojave,
Ka dy mijë vjet që pret të hyjnë brenda njerëzit,
T'u fërkohet pas këmbëve, të mjaullijë...
Macja e larme që shullëhet në diell,
Kthen kokën anash si një hyjni ilire,
Që e kanë lënë aty për të trembur vdekjen.

Durrës, 1985

DEHJA E PLINIT (PLAKU)

Ai ecte. Nën këmbë i shungullonte dheu.
Drurët në shpate luhateshin si të pirë.
Ai ecte. Marrakëmbthi. Vështronte si i dehur.
Ai ishte dehur vërtet me atë afsh të përbindshëm,
Që i kishte rënë në kokë si avull mushti...
Të tjerë, shumë larg që andej. të shtruar në orgjira,
Zgjatnin duart babëzisht drejt kupash të çmuara.
Për të rrëkëllyer në fyt pijet magjike.
Ai ecte syetur, duarshtirë, kraharoreshpirtpërflakur
Drejt asaj kupe vigane me emrin Vezuv,
Ku gurgullonte musht lave
Nga e zjarrta vozë e rruzullit.
I etur për të pazbuluarën, për të panjohurën,
Me atë marrosjen sublime të dijetarit,
Ai i afrohej me ngulm kraterit të kobshëm —
Sfidë tejet e madhe dhe e pamatur.
Një hap i tepërt në zgrip të rrezikut
Dhe dijetarin e përpiu gurmazi i zjarrtë...
Të tjerë vazhdonin të pinin në gostira,
Të deheshin, të binin shakull mbi mozaikë mermeri,
Të vdisnin dita-ditës, duke mbetur gjallë edhe pak kohë,
Për të vdekur më vonë me gjithsej.
Ndërsa ai, dijetari i etur për të panjohurën.
I dehur me musht lave,
Ka shekuj që rrökulliset në krater.
Kërkon të fshehtat në angrrat e vullkanit
Dhe nuk mundet të vdesë. Nuk vdes.

TË ECËSH NËPËR MANGALEM

1

Qyteti është ngjeshur pas shkëmbit,
Duke dashur t'i ngjajë atij,
Duke dashur të njëjtësohet me të.

2

Të ecësh nëpër Mangalem:
Të harrosh ikjen e kohës,
Të harrosh ndërrimin e stinëve,
Të harrosh se gjërat plaken,
Të harrosh se vdes njeriu!

3

Këtu tërë jetën njeriu ka zbukuruar gurin.
Këtu guri e bën njeriun më të bukur.

4

Një zë vajze jehon përtej:
Ruga shndërrohet në tel violine
Midis mureve të Mangalemit.

5

Karafila të çelur, fytyra vajzash në dritare...

Limonët zgjaten mbi gurët e rreshkur,
Sikur duan të përkëdhelin gërshetat e vajzave!

NË BREG TË DRINIT

E hirta përpiu ngjyrat. Muzgu ra.
I mbyllën krahët si shqiponja guri malet
Këndeje e andej Drinit, duke pritur të nesërmen
Për t'u hovur prapë në qiell.
Lundra e lashtë e gjysmëhënës doli
Te liqeni i ri ku rrënjët i ka drita,
Që u ndez në fshatrat e breglumit, tej në qytete...
Ndanë liqenit ia behu Pjetër Budi;
Me mjekrën si përrua. me flokët e thinjur,
Ku kishin ngecur rërë e myshqe shekullore.
Në ujë lëkundej lundra e gjysmëhënës,
Sikur nga buzë e saj dikë donin të mbytnin.
Me tmerr në sy. ai u kthve nga fshatrat,
Nxori nga goja një thirrje treqindvjeçe;
Përnjëherësh u hapën dyert e njëqind kullave
Dhe malësorët me pishtarë në dorë
Drejt tij nisën të vinin... Dhe digjej nata
Nga drita fshatrash që çelnin mbi shkëmbinj
Si zambakë shqiptarë.¹⁾

1) *Lilium albanicum* ka lule ngjyrë portokalli, rritet vetëm në Shqipëri

PIKTORI

A. Buzës

Njerëzit e ardhur për ngushëllim
Bëjnë gjeste rituale, thonë fjalë rituale.
Nëpër tablotë e varura në mur
E kuqja, e blerta, e kaltra,
Gjaku, lulëkuqet, bari, dielli,
Fëmijët, valltarët, frutat...
Po e zeza, ku është e zeza?
E zeza e përzishme s'është askund.
Po piktori?... Ku është piktori?!
Piktori është diku prapa tablove,
Ja, tani do të nxjerrë fytyrën pas tyre
Si fëmijët që luajnë kukafshehthi në pyll,
Agullimi do t'i ulet në buzë,
Veriu që valëvit grunjërat në rrafsh,
Do t'ia trazojë flokët e argjendtë.
Piktori do të zgjatë krahun,
Brushën do ta ngjyjejë në palitrën e vjeshtës
Dhe të gjitha ngjyrat do të vallëzojnë
Rreth piktorit
Që ia punoi vdekjes.
Vdekja do të largohet buzëvarur.
Vdekja me të verdhën e gjetheve të rena
Në studio kurrë s'do t'i trokasë!

16.11.1986

STATUJA E ALI KELMENDIT

Si një dorë nëne
Bora i rrinte mbi ballë.

Mos vallë ia çoi atë borë
Vendlindja e largët?

Si një dorë nëne
Bora i rrinte mbi ballë.

Sytë i kishte të rrëmbushur
Me Pejë dhe mall!

Korçë, 1987

MËSHTEKNAT

U shkri bora që ra në të gdhirë...

Mbështeknat e mbajtën bardhësinë e saj,
Siç e ruajnë fytyrat e vajzave
Gëzimin e dashurisë.

PASDITE PRILLI NË SHKODËR

Mbretëreshë hijerëndë,
Hiqe kurorën e sovranes,
Zbrit nga kullat e gurta të kështjellës.
Unë, bujtësi i sapoardhur,
Do të flas me ty për Shkodrën e re.
Do të shëtitim nëpër rrugët e mëdha
Të këtij qyteti me mushkëri të gjera,
Të ajrosura nga fryma e bjeshkëve.
Do të shohim pleq të ulur në parqe,
Të pashëm, të menduar si shtatore rilindësish.
Do të dëgjojmë zërin e ëmbël të shkodraneve,
Që i ngjan aq shumë një cicërime. . .
Mos u trishto, mbretëreshë kryelartë,
E mbështjellë me tis legjende:
Ti s'hahesh dot me bukurinë e Shkodrës
Që ka hequr nga fytyra rrudhat e shekujve.
N'u trishtofsh,
Do të ndal në rrugë vajzën më të bukur
Dhe do t'i them me seriozitetin më të madh:
Ti je mbretëresha Teutë!
Trëndafilin e diellit që perëndon mbi kreshta,
Do t'ia dhuroj si ilirët e dikurshëm.
Kështu do të bindesh se nuk je vetëm mjegull
Që endet në ato mure të gurta.

FËMIJA

Një fëmijë qan diku larg,
E qara e tij mbush qiell e dhé.
Fluturat krahëshkruara i sillen përçark,
Por fëmija sypërlotur as që i sheh.
Lulet e fushës, lulet e malit
Drejt tij përkulen,
Por fëmija nuk ndalet.
Zogjtë e larmë i ulen mbi supe,
Me zërat e burimeve në sqep,
Por fëmija as që e pushon të qarët,
Ecën,
Me ato klithma të zgjatura përpara
Si duar të verbri,
Me ata lot ku lëkunden malet,
Ku përthyhen muret e kështjellës.
Fëmija ecën dhe qan,
Gurët e kalldrëmit ngjishen pas njëri-tjetrit,
Të mos i vriten këmbët e zbathura,
Shkëmbinjtë e zhveshur
Mbulohen me bar...
Fëmija shtyn me duar kohërat,
Zhvendos në themele gurët e murrinë,
Kërkon nënën e tij të murosur
Te ledhi i lashtë që pikon qumësht.
Qan fëmija
Dhe atë qarje s'e mbytin dot

As erërat, as rrethimet,
As trokëllimat e karvaneve, as fishkëllimat e trenave:
Ai fëmijë që kërkon nënën e tij,
Qan brenda meje!

Kështjella e Rozafës, prill 1989

BALADË PËR KUAJT

Kuajt e vjetër që mezi mbaheshin në këmbë,
Verës i çonin në bjeshkë.

Një ditë para se të zbritnin në vërrin,
i linin në kullota të largëta:

Iknin qëmenatë, thua se iknin fshehurazi.

U bëhej sikur dëgjonin pas shpine nëpër gryka e qafa,
Hingëllimat e kuajve të vjetër.

U therte në zemër: po ku ta gjenin sanën?

Fshikullonin kuajt e rinj, me vithe të gjera,

Mallkonin me vete dimrin e rëndë e të gjatë.

Nëpër muzgjet që kundërmonin fruta të pjekura,
Deri në kullat e gurta zgjateshin

hingëllima të njohura:

Nga bjeshkët kishin zbritur fillikat kuajt e vjetër,

Me krifa të shpupurishura, me sy të pikëlluar.

Duke fshirë nga faqja e ashpër një çurg lotësh,

Të zotët ua lëmonin ijet e djersitura,

sikur u lypnin të falur,

Ua shtronin krifat plot rrodhëza, i futnin brenda.

Ku do ta gjenin sanën?

Dimri do të ishte i gjatë dhe i rëndë.

Verën e ardhshme kuajt e vjetër i çonin prapë në bjeshkë
Dhe prapë i linin në livadhe të largëta.

Shumë ditë më vonë,
Madje edhe pasi kishte rënë bora e parë,
Prisnin të dëgjonin në muzg hingëllimat e njohura...
Tani vetëm siluetat e mjegullta të kuajve
do të shfaqeshin në oborre
Me sy të pikëlluar, me krifa të shpupurishura.
Njerëzit ndienin në kraharor një gropë të thellë:
Diçka kishte ikur përgjithmonë nga jeta e tyre
Bashkë me kuajt e vjetër.

SHKALLINA ME BUZË TË THYER...

Ka dyzet vjet që kjo shkallinë me buzë të thyer
Është kështu. Giithçka ka ndryshuar te kjo shtëpi,
Vetëm kjo shkallinë ka mbetur siç ka qenë
Në vitin 1944... Atë vit që dimër i rëndë.
Borë. Ngricë. Partizanët erdhën këtu në mes të natës.
Ata kishin ecur gjatë nëpër borë,
Të ndjekur nga plumba të huaj, nga currila gjaku,
Nga rriba e murrllanit, nga ulërima ujkonjash.
Para se të hynin në shtëpi,
Partizanët shkundën borën e ngiitur pas këpucëve.
Atë natë u thye kjo shkallinë nga këpucët e ngrira...
Të thashë: gjithçka ka ndryshuar këtu,
Përvec qiellit dhe kreshtave të maleve,
Por ne e kemi ruajtur si një send të vyer
Këtë shkallinë ku shkundën partizanët
Këpucët me borë të ngrirë.

1984

DITA ME TETËDHJETË DIEJ...

Mane Avdyli gatoi 80 bukë për partizanët
që u mbledhën në fshatin Shkëlzen
në mars të vitit 1943.

Koha nxinte, moj nënë, e Shkëlzeni shkëlqente:
Ishin shumë ata trima me yll në ballë,
Me qiell malësie, me qiell rrafshi në sv.
Ishin të uritur, moj nënë, ishin të uritur ata trima.
Ishin të uritur për bukë e liri.
Koha nxinte, moj nënë, e Shkëlzeni shkëlqente.
Në vatrën e kullës flaka vallëzonte.
Flaka vallëzonte e prushi bëhej pìrg,
Ti mburjte me duart e tua tetëdhjetë bukë.
Vetë i mburjte dhe i boqe për t'ua dhënë trimave,
Se ishte dimër i madh, se ishin të gjatë udhët,
Se ishte e madhe, moj nënë, uria e tyre,
Uria e tyre për bukë e liri...
Koha nxinte, moj nënë, e Shkëlzeni shkëlqente.
Ata thanë se do të vinte një ditë e madhe,
Një ditë e madhe, moj nënë, me tetëdhjetë diej,
Sa tetëdhjetë bukët e tua prej misri të kuq.
U nisën prapë në udhë ata trima me yll në ballë,
Shumë prej tyre, moj nënë, ranë si yj të këputur,
Ranë si yj të këputur nëpër borë e plumba,
Në luginat e Drinit, në grykat e Sharrit,
në Judovnikun me borë.

Shokët e tyre, moj nënë, në gjakun e tyre u betuan,
U betuan për të sjellë ditën e madhe,
Ditën e madhe me tetëdhjetë diej...
...oha nxinte, moj nënë, e Shkëlzeni shkëlqente.

NËNSHKRIMI

Ishte pisku i luftës.
Krerët i mblodhën burrat e një fshati në kuvend,
U folën gjatë për «të kuqtë»
Që nuk njihnin zot. atdhë, babë as nënë.
U premtuan rroga, grada dhe armë,
Po të futeshin në çetat e tyre.
Shkruesit nxorën nga çantat ushtarake
Letrat e bardha të listave.
Asnjë malësor nuk lëvizi nga vendi,
Nuk pranoi të shkruante emrin, të vinte gishtin
Tek ato letra të bardha që i trazonte era.
Atëherë krerët thirrën më plakun e fisit,
(Po të thyhej ai, të tjerët do të thyheshin
më lehtë),
U përpoqën ta blinin me një grusht florinj
Dhe më në fund i thanë:
Zgjidh kë të duash, veç shkruaje emrin në një listë! . . .
Pasi ua nguli sytë krerëve, letrave të bardha,
Plaku zgjati dorën para tij
Dhe tha:
Unë dua ta shkruaj emrin në këtë lis,
Se ky lis ka mbirë në truall! . . .

Kaq foli plaku dhe u largua.

CILI MAL TA FALI BORËN?

Cili mal ta fali borën e parë
Për ta vënë ti në faqe?

Cili zambak erdhi nga kopshtet
Për të lulëzuar te qafa jote?

Cili agim e pikoi atë vesë
Që të vezullon në bebëza?

Cili livadh të solli barin e ri
Për të bërë prej tij qerpikët?

Cila pemë e nisi atë beng
Që të cicëron në bisk të vetullës?

Cila stinë ta dha ditën më të bukur
Për ta vënë te buzët e tua?

**DUKE T'I HUKATUR DUART
NJË DITË DIMRI**

E di: kjo frymë që po hukat.
Kurrë më s'do të kthehet tek unë.
Kjo ngrohtësi që del prej meje
S'do të hyjë prapë në trupin tim.

Ti merri frymën, ngrohtësinë, të puthurat
Që të parat s'do të jenë kurrë më.
S'do të jenë kurrë më kaq të druajtura
Dhe për ty s'do të jenë të fundmet...

E dashura ime, merre këtë frymë,
Tërë qenien time prej mishi dhe fjale:
Tashmë nuk e di ku fillon ti
Dhe ku mbaron vetja ime!

ATY KE GJITHNJË HIR VASHËRIE...

Mos u vono, e dashur, te pasqyra,
Për të hetuar ndonjë thinjë të re,
Ndonjë rrudhë të zgjatur te fytyra,
Shpor urithi që rrëmon nën dhé.

Vilen e brengës me kokrra të fryra
Në syrin tënd nuk dua ta vë re.
Ndryshe je ti e ndryshe shembëlltyra,
Të luan rreng pasqyra, të bëj be.

Kjo bebëz qelqi ty të mban mëri,
Thinja, rrudha t'i shton prej zilie:
Duke qeshur, qindra herë e ngjethe.

Shihu, e dashur, veç në sytë e mi:
Aty ke gjithnjë hir vashërie,
Të kuq molle që fehton ndër gjethe.

PASQYRA

1

Dashuria ime ishte një pasqyrë
Ku fytyrat e tjera dukeshin e zhdukeshin,
Vetëm fytyra jote mbetej gjithnjë aty:
Ajo ishte midis xhamit e mërkurit.

2

Të kam dashur,
Siç merr mushkëria frymë.
Siç jep zemra gjak.

3

Në çaste hidhërimi e vetmie,
Dashuria ime vinte drejt teje
Si një zog që kërkon folenë nëpër shi.

4

Vetëm duke të dashur ty,
Isha me të vërtetë njeri i plotë.

5

Edhe kur të më mbyllen sytë përjetë,
Dashuria ime do të jetë një dritare e hapur,
Një zë që thërret dikë në orët e vona...

NËN TRUNGUN E MANIT TË ZI

Dridhet mani si një qiell i blertë,
Kokrrat e pjekura bien si yje.

Një çunak i hajthëm ulet në një degë
Dhe bën mustaqe me lëng mani,
T'u ngjajë të rriturve.

Varet nga degët dhe hidhet në bar
Çunaku i dikurshëm me tiparet e mia.

Dua të flas me të: ai hesht.
Dua ta prek me dorë:
Ai ikën...

I vetëm, i thinjur qëndroj
Nën trungun e manit të zi.

Kurrë, kurrë s'do të takohen
Çunaku që bënte mustaqe me lëng mani
Dhe burri me thinja!

Mbi barin e blertë
Manat e pjekur bien si yje.

PËRSE SHKRUAJ?

Këtë pyetje ma kanë bërë disa herë:
Kam ngritur supet, kam heshtur.
Përse shkruaj?... Kjo pyetje më duket pa kuptim
Dhe në njëfarë mënyre e papërgjigje
Si pyetjet: Përse kam lindur? Përse marrë frymë?
Përse eci? Përse kam zë? Përse kam dorë?
Përse dora ka pesë gishta?
Përse gishtat janë bërë të aftë për të shkruar?
Përse qesh? Përse ndiej dhimbje?...
Përse shkruaj?... Unë besoj te fjalët që thotë Marksi
Se artisti krijon me po atë domosdoshmëri
Që krimbi i mëndafshit prodhon mëndafshin.
Është e vërtetë se në ndonjë rast ligështimi, brengje,
Jam betuar me vete të mos shkruaj më asnjë varg,
Por këto betime janë shembur si penda rëre,
Kur lumi i frymëzimit ka mbushur zallin e tharë.
Përse shkruaj?... Sigurisht jo për honorare,
As për ta parë emrin tim në vitrina,
As për të më ndjekur me sy në rrugë kureshtarët,
Për të ngritur folenë nëpër fletë antologjish.
Shkruaj pa menduar se poezia zëvendëson bukën,
Pa iluzionin romantik se ajo do ta ndreqë botën,
Se mund të ndryshohet i ligu thjesht me vjersha,
Por i bindur se poezia e mirë krijon një klimë
Ku bëhet e padurueshme çnjerëzorja dhe e keqja.
Përse shkruaj?... Kjo pyetje më kujton fëmijërinë,

Barinjtë e vetmuar që këndonin në bjeshkë,
Pa menduar se këndonin enkas për dikë,
Por duke e ndier se ajo këngë i lidhte me njerëzit.
Përse shkruaj?... Këtë do ta them me saktësi
Vetëm pasi të kem vdekur.

PËRMBAJTJA

GJETHNAJA NË TRUP

Gjethnaja në trup	5
Bisedë imagjinare me një punëtor	6
Dielli hyn e del nëpër syrin tim	8
Lisi në kodër	9
Vegim fëmijërie	11
Librat e një mësuesi	12
Muzg	14
Njoh një poet	15
Mesvjeshtë në pyll	17
Grindje me fjalët... ..	18
Lule që çele e para	19
Në të dalë të dimrit	20
Pesha e një dite me diell	21
Nyjë gjaku	22
Dega e shelgut	24
Çelësi	25
Magjia e balonave të fëmijëve	27
Djali udhëton	28
Ëndërr	30
Mrizi i largët	32
Në të gdhirë dëgjova sirenën	33
Një gur më kërkon	34

DIETË PËR T'U PLAKUR NGADALË

I them vetes	39
Ngujim modern... ..	40
Pemët gjeometrike	42
Frutë e kalbur	43
Më thotë një kryeartëz	45
Grotesk	46
Potkoi	48
Matrapazëve të autoreklamës	49
Qiparisat e heshtur	50
Serioziteti i fëmijëve	51
Grerëzat	52
Engjëj... ..	53
Për një libër	54
Narcisoidi	55
Shpejtësitë	56
Dorëshkrimet	57
I frikshmi	59
Vargjet e ronitura	61
Dietë për t'u plakur ngadalë	63

DHIMBJE VËLLAI

I — Thika e përgjakur

... E në sy u digjet Mesjeta	67
Ndërro emrin!... ..	69
E ti i the	71
Të rrosh në këmbë	72
Kështjellari	73
Qorbi i lashtë	74

E urrej atë njeri...	76
Burrat e dheut	77
Letra e djegur me cigare	79
Trëndafilat e bardhë	81
Ballaban Pashës	82
Thika e përgjakur	83
Ulliri i të shpërngulurit	84

II — Ditar mërgimtari

Rruga	86
Mëngjes i dhimbshëm	87
Mërgimtari i papunë	88
Prapa xhamit	89
Ndërtoni çerdhe, zogj...	90
Malli i shtëpisë	91
Heshtja më flet për ty	92
Ka çaste kur i kam mëri sytë e mi...	93
Të kërkoj me sy kudo...	95
Iluzion	96
Merimanga	97
Fjala afrohet pranë fjalës	98
Çdo natë	99

DIEJT E IKUR

Diejt e ikur...	103
Macja e larme...	104
Dehja e Plinit (Plaku)	105
Të ecësh nëpër Mangalem	106
Në breg të Drinit	108

Piktori	109
Statuja e Ali Kelmendit	110
Mështeknat	111
Pasdite prilli në Shkodër	112
Fëmija	113
Baladë për kuajt	115
Shkallina me buzë të thyer... ..	117
Dita me tetëdhjetë diej... ..	118
Nënshkrimi	119
Cili mal ta fali borën?	120
Duke t'i hukatur duart një ditë dimri	121
Aty ke gjithnjë hir vashërie... ..	122
Pasqyra	123
Nën trungun e manit të zi	125
Përse shkruaj?	126

Papleka, Ndoc
Gjethnaja në trup: Poezi / Ndoc Papleka;
Red.: S. Arbana. — T.: Naim Frashëri,
1990. — 134 f.; 18 cm.

891.983-1

P 24

Tirazhi 2000 kopje

Formati 70x80/16

Stazh 2204-82

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «Nëntori» — Tiranë, 1990